



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. 216/4 prot.

Tiranë, më 07.03 2025

Lënda: Dërgohet për njohje dhe zbatim Urdhri nr. 216/2 Prot., nr. 28, datë 07.03.2025
“Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror
për vitin 2025”.

22 ZYRAVE VENDORE PËRMBARIMORE

Të nderuar,

Me Urdhër nr. 216/2 Prot., nr. 28, datë 07.03.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit është miratuar Plani i Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror për vitin 2025. Ky dokument është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, si dhe në bazë të rekomandimeve të Ministrisë së Drejtësisë.

Masat e parashikuara në këtë plan rrjedhin nga objektivat dhe prioritetet e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe synojnë përmirësimin e eficiencës, transparencës dhe mbikëqyrjes në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror. Plani fokusohet në forcimin e kapaciteteve profesionale, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe adresimin e sfidave në zbatimin e titujve ekzekutivë, me qëllim ofrimin e një shërbimi më të aksesueshëm dhe efektiv për qytetarët, në përputhje me standardet më të mira.

Në vijim, ju përcjellim për njohje dhe zbatim Urdhrin nr. 216/2 Prot., nr. 28, datë 07.03.2025 “Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror për vitin 2025”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. 216/prot.

Tiranë, më 07.03 2025

URDHËR

Nr. 28, Datë 07.03 2025

PËR

**“MIRATIMIN E PLANIT TË ZHVILLIMIT TË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR
GJYQËSOR SHTETËROR PËR VITIN 2025”**

Në zbatim të nenit 8, pika c të Ligjit nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022 – 2026, Strategjisë për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030, shkresës nr. 811/2 Prot., datë 05.03.2025 të Ministrisë së Drejtësisë,


URDHËROJ


1. Miratimin e Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror për vitin 2025.
2. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Zyrat Vendore Përmbarimore, për zbatimin e këtij Urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Ligjore dhe Shërbimeve Mbështetëse, për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ERGJYRI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**

PLANI I ZHVILLIMIT TË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR PËR VITIN 2025

Misioni i shërbimit të përmbarimit gjyqësor shtetëror, është realizimi i të drejtës së qytetarit të fituar në rrugë gjyqësore, si hallkë fundore e procesit gjyqësor ku përmbaruesit gjyqësor, me qëllim garantimin e të drejtave të fituara nga qytetarët në rrugë ligjore kryejnë procedurat përmbarimore të përcaktuar në dispozitat ligjore në funksion të ekzekutimit tërësisht të titujve ekzekutiv. Ligjshmëria dhe objektiviteti, si dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj subjekteve që marrin pjesë në ekzekutim, janë parimet bazë të punës së Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.

Plani i Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror (SHPGJSH) synon të përmirësojë eficiencën dhe efektivitetin e këtij shërbimi, duke garantuar zbatimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Përmirësimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është një proces kompleks që kërkon angazhim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Duke përcaktuar këto objektiva konkrete, mund të kontribuohet në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe rritjen e besimit të qytetarëve në autoritetet ligjore.

Hartimi i këtij Plani Zhvillimi të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror mbështetet në:



Ligjin nr.8678 datë 14.05.2001 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar

Ligjin 8/2023 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar

Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

Ligji nr. 115/2024 “ Për Buxhetin e vitit 2025”,

Ligji 92/2014 “Mbi Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”

Ligji Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit“,

Ligji 9975 datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar

Ligji 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar

Urdhër nr. 432, datë 30.06.2023 i Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”,

Urdhër nr. 433, datë 30.06.2023 i Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësor shtetëror në periudhë prove”,


Urdhër nr.333 datë 18.06.2024 i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësor shtetëror”, bazuar në nenin 22, pika 3;

Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar ,

Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”,i ndryshuar,

Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 24.01.2025 “ Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2025”,

Udhëzimin e Përbashkët Nr.1276/5, datë 27.07.2017 “Për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror” , i ndryshuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.32, datë 30.08.2018 “ Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përbashkët Nr.1276/5, datë 27.07.2017 “Për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”



Me vendimin nr. 787 datë 18.12. 2024 të Këshillit të Ministrave u miratua Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030, e cila përmban objektivat më të rëndësishëm dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj për 7 vitet e ardhshme për sistemin e drejtësisë, hartuar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Ky dokument strategjik ka parashikuar edhe masa strategjike për institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit (DPP), të cilat janë përkthyer në masa/aktivitete konkrete në Planin e Punës së DPP.

➤ **Objektivat e planit të zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror**

1. Përmirësimi i Eficiencës:

Nëpërmjet këtij objektivi synohet rritja e nivelit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv të regjistruar për ekzekutim pranë Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror si dhe kryerja e veprimeve procedurale nga aktorët kryesorë, përmbaruesit gjyqësor, me efikasitet, saktësi dhe në zbatim të dispozitave ligjore.

2. Forcimi i Kapaciteteve Institucionale

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor me miratimin e Ligjit të Ri 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë rekrutimit të përmbaruesve gjyqësor, duke vendosur kritere në përputhje me standartet e drejtësisë së re. Nëpërmjet objektivit të lartpërmendur synohet jo vetëm rekrutimi i përmbaruesve të rinj sipas kriterëve të veçanta të përcaktuara në ligjin organik por edhe organizimi i trajnimimeve i vazhdueshëm i tyre me qëllim përmirësimin e punës së tyre, rritjen e nivelit të ekzekutimit, unifikimin e praktikave përmbarimore etj. Vlerësimi i personelit dhe të merrja e masave për politika të promovimit në bazë të meritave; Sistemimi i zyrave vendore me ambiente të përshtatshme për ushtrim aktiviteti; Planifikim dhe furnizim me paisje zyre, mjete logjistike dhe paisje elektronike për shërbimin.

3. Monitorimi i veprimtarisë së përmbaruesve gjyqësor




Ngritja e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi të performancës së punonjësve të përmbarimit nëpërmjet kryerjes së ushtrimit të kontrolleve periodike dhe atyre të veçanta, (në bazë ankesash), ku synimi është verifikimi ndjekjes së veprimeve procedurale nga ana e zyrave vendore përmbarimore për çdo çështje përmbarimore, duke respektuar me korrektësi afatet procedurale të përcaktuara në ligj. Ndjekja në dinamikë e procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë me tregues statistikor progresiv mujor. Trajtim i veçantë për çdo çështje që mbart problematikë në ekzekutim dhe ofrimi i rrugëve të zgjidhjes. Marrja e masave ligjore ndaj përmbaruesve që shkelin dispozitat ligjore në procedurat e ndjekura për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe titujve të tjerë ekzekutiv.

4. Përmirësimi i Shërbimeve për Qytetarët

Rritja e transparencës dhe aksesit në informacion për qytetarët rreth procedurave të përmbarimit. Ofrimin e informacionit në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, të mjaftueshëm, të saktë dhe lehtësisht për tu kuptuar dhe për tu përdorur nga qytetarët. Përditësimi i programi i transparencës në faqen zyrtare të DPP, duke përditësuar me informacionin e duhur mbi Kodin Etik, Konfliktin e Interesit, Mbrojtjen e sinjalizuesve, raporet vjetore, vendet vakante, personat e kontaktit etj. Të ofrohet informacion në kohën e duhur nëpërmjet faqes zyrtare të DPP për veprimtarinë e shërbimit.

Objektivat e lartpërmendur, gjenden në mënyrë të detajuar të përshkruar në tabelën bashkengjitur këtij plani zhvillimi të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, në të cilën përshkruhen objektivat e parashikuara të detajuara, masat dhe veprimet e planifikuara, drejtoritë/sectorët përkatës, kuadri kohor dhe treguesit e suksesit.



5. Bashkëpunimi institucional

Rritja e bashkëpunimit institucional, me institucione të tjera si ASHK, DPSHTRR, IKMT për të siguruar ekzekutimin e titujve ekzekutiv.

Gjatë ushtrimit të kontrolleve periodike si dhe atyre të ushtruar në bazë ankese apo edhe gjatë shqyrtimit të ankesave të përcjella në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit është konstatuar se një numër i lartë titujsh ekzekutiv kanë mbetur pa ekzekutuar ose pa marrë zgjidhje ligjore për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe ofrimit të mbështetjes nga institucionet që kanë detyrim ligjor bazuar në dispozitat ligjore siç janë ASHK, DPSHTRR, IKMT

Mungesa e këtij bashkëpunimi ka rritur numrin e titujve ekzekutiv të paekzekutuar, e për rrjedhojë ul efikasitetin e shërbimit përmbartimor gjyqësor, në këto kushte DPP ka vlerësuar se ngritja e urave të bashkëpunimit me këto institucione, edhe pse këto të fundit e kanë detyrim ligjor bashkëpunimin, do të sillte efikasitet, rritjet të numrit të titujve ekzekutiv të ekzekutuar. Përmbushja e këtij objekti synohet të arrihet nëpërmjet kërkesave për bashkëpunim dhe takimeve dypalëshë me qëllim propozimi i zgjidhjeve sa më efektive, në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.



Plani i Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror					
➤ Realizmi i ekzekutimit të vendime gjyqësore civile dhe titujve të tjerë ekzekutivë.					
Nr	Objektivat	Masa dhe veprime te planifikuara	Institucioni përgjegjës/Drejtoritë dhe Sektorët përgjegjës	Kuadri kohor Viti 2025	Treguesit e suksesit
1	Përfundimi i kornizës ligjore të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.	Ndjekja e procesit mbi përfundimin e akteve nënligjore në zbatimit të Ligjit 8/2023 dhe Urdhërit nr. 157 datë 07.02.2023 të Ministrit të Drejtësisë, në vijimësi.	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit. Grupi i Punës i caktuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë.	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II-të, , 3 mujori i III-të, 3 mujori i IV-të, 2025	Permirësim i cilësisë së shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.



2	Ndjekja e procedurave të Këshillit Përmbartimor.	Ndjekja e procedurave të Këshillit Përmbartimor në lidhje sipas detyrimeve që përcakton Ligji 8/2023, në lidhje me vëndet vakantë, masat disiplinore etj.	Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave Drejtoria e Burimeve Njerezore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështjeve Ligjore	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II-të, 3 mujori i III-të, 3 mujori i IV-të, 2025	Ndjekja me përgjegjësi e procedurave përkatëse.
3	Realizimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqesore civile dhe titujve të tjere ekzekutive, respektim rigoroz i afateve ligjore.	Ndjekja e veprimeve procedurale nga ana e zyrave vendore përmbartimore për çdo çështje përmbartimore, duke respektuar me korrektësi afatet procedurale të përcaktuara në ligj. Ndjekja në dinamike e procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë me tregues statistikore progresiv mujor. Trajtim i vecantë për çdo çështje që mbart problematike në ekzekutim dhe ofrimi i rrugëve të zgjidhjes. Marrja e masave ndaj përmbartuesve ligjore që shkelin dispozitat ligjore ne procedurat e ndjekura per ekzekutimin e vendimeve gjyqesore dhe titujve të tjerë ekzekutivë.	Drejtoria e Inspektimit dhe e Shqyrtimit të Ankesave Drejtoria e Burimeve Njerezore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështjeve Ligjore 22 Zyrat Përmbartimore	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II-të, 3 mujori i III-të, 3 mujori i IV-të, 2025	Titujve ekzekutivë të ekzekutuar terësisht në trend rritës krahasuar me vitin paraardhës. Realizimi i të drejtës së palëve në proces ekzekutimi. Rritje e cilësisë së shërbimit të ofruar.



4	Rishikim i rregullores së brendshme të Sherbimit të Përmbaarimit Gjyqësor Shtetëror pas miratimit të ligjit dhe strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaarimit me ndryshimet e propozuara.	Verifikimi i ndryshimeve të duhura në rregullore në përshtatje me ndryshimet ligjore dhe organikën e Sherbimit Përmbaarimor Gjyqësor Shtetëror. Hartimi i projektdraftit nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaarimit. Diskutime në grupe pune të ngritura për këtë qëllim. Dërgimin për miratim të rregullores së re në Ministrinë e Drejtësisë.	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaarimit Grupi i Punës i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm	3- majori i I-rë, 3-majori i II-të, 3 majori i III-të 2025	Akte nënligjore të kompletuara në përshtatje me aktet ligjore dhe organikën. Kompetenca të qarta dhe të përcaktuara për cdo sektor dhe drejtori të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaarimit si dhe për cdo pozicion të shërbimit përmbaarimor gjyqësor shtetëror.
5	Rishikim i rregullores së brendshme të Sherbimit Përmbaarimor Gjyqësor Shtetëror "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Sherbimin Përmbaarimor Gjyqësor Shtetëror", e përshtatur me ndryshimet ligjore të miratuara.	Miratimi i projekt - rregullores së re nga Ministri i Drejtësisë	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaarimit Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.	3 - majori i III-të dhe 3 - majori i IV - të 2025.	Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Sherbimin Përmbaarimor Gjyqësor Shtetëror të përshtatur me ndryshimet ligjore.
6	Hartimi i një rregulloreje për mbrojtjen, rruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Sherbimin Përmbaarimor	Hartimi i një projektdraftit nga drejtoria e Përgjithshme e Përmbaarimit. Diskutime në grupe pune të ngritura për këtë qëllim. Dërgimi për miratim të rregullores nga Ministri i Drejtësisë.	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaarimit Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave	3 - majori i III-të dhe 3 - majori i IV - të 2025.	Shërbim përmbaarimor gjyqësor shtetëror i kompletuar me akte nënligjore. Përcaktimi i procedurave dhe masave konkrete për mbrojtjen, rruajtjen, përpunimin dhe



	Gjyqësor Shtetëror, e pershtatur me ndyshimet ligjore të miratuara		Sektori i Financës dhe Buxhetit Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështjeve Ligjore		administrimin e të dhënave personale në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.
7	Rritja e nivelit profesional të përmbaruesve gjyqësorë nëpërmjet trajnimeve	Krijimi i mundësive për trajnime të vazhdueshme dhe efikase për përmbaruesit gjyqësor të shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror. Krijimi i mundësive për trajnime për përmbaruesit gjyqësor në periudhë prove. Hartimi i një plani trajnime duke u bazuar në Mundësi konkrete zbatimi dhe afate kohore Forcimi i trajnimeve për përmbaruesit për të përmirësuar aftësitë e tyre në çështjet e ndërlikuara ligjore dhe sociale”.	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Zyrat Vendore Përmbarimore ASPA	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II – të, 3 - mujori i III-të dhe 3 - mujori i IV - të 2025.	Rritje e cilësisë në punë. Përmbarues të trajnuar për ekzekutimin e drejtë dhe në kohë të çështjeve të ndryshme.
8	Më bërjen funksional të sistemit ALBIS, i cili bazuar në VKM, nr. 443 datë 16.6.2011 është në administrim të Ministrisë së Drejtësisë, do të vijohet me impementimin e tij.	Më bërjen funksional të këtij sistemi, do të vijohet me impementimin e tij, në të gjitha zyrat përmbarimore. Hedhja e të dhënave nga të gjithë përmbaruesit në sistemin Albis	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.	Në vijimësi	Rritje e numrit të çështjeve përmbarimore të administruara elektronikisht.



9	Raportimi, dhënia e kontributit në strategjitë ndërsektoriale. Realizimi e masave të parashikuara për vitin 2025	Realizimi i masave dhe objektivat e parashikuara për vitin 2025 në: -Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030. <u>Aktiviteti 3.1.6.2:</u> Plotësimi i vakancave në referim te gjetjeve te analizës. <u>Aktiviteti 3.1.6.3:</u> Vlerësimi periodik i nevojave për trajnim vazhdues dhe trajnim i specializuar sipas fushave. <u>Aktiviteti 3.1.6.4:</u> Trajnimi vazhdues i punonjësve të shërbimit përmbarimor gjyqësor lidhur me procedurat e ekzekutimit. <u>Aktiviteti 3.1.6.5:</u> Rishikimi dhe përditësimi i programeve të trajnimit të punonjësve të shërbimit të përmbarimit gjyqësor per procedurat e ekzekutimit. <u>Aktiviteti 3.1.6.7:</u> Hartimi i analizave, duke përfshirë një plan (nga secili institucion), për ekzekutimin në kohë dhe në mënyrë efikase të vendimeve gjyqësore, identifikimin e arsyeve të vonësve dhe sugjerimin e masave korrigjuese. Afati i përfundimit – viti 2025. <u>Aktiviteti 3.1.6.8:</u> Zbatimi i masave të parashikuara në analiza dhe në plan veprimi	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave Sektori i Financës dhe Buxhetit Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështjeve Ligjore	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II – të, 3 - mujori i III-të dhe 3 - mujori i IV - të 2025.	Kritje e cilësisë së shërbimit përmbarimor. Dhënie e shërbimit të ekzekutimit të Titujve Ekzekutiv me korrektësi dhe përgjegjshmëri.
---	--	--	--	---	--



për ekzekutimin në kohë dhe në mënyrë efikase të vendimeve gjyqësore. Afati i përfundimit – viti 2025.

Aktiviteti 3.2.6.4: Hartimi i analizave, duke përfshirë një plan (nga secili institucion), për ekzekutimin në kohë dhe në mënyrë efikase të vendimeve gjyqësore, identifikimin e arsyeve të vonesave dhe sugjerimin e masave korrigjuese. Afati i përfundimit – viti 2025.

Aktiviteti 3.2.6.6: Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet e tjera të cilat kanë funksione lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nëpërmjet organizimit të takimeve të përbashkëta, seminareve, diskutimeve, masave të përbashkëta etj. Afati i përfundimit – viti 2025.

Aktiviteti 3.3.4.1: Hartimi i analizave duke përfshirë një plan (nga secili institucion), për ekzekutimin në kohë dhe në mënyrë efikase të vendimeve gjyqësore, identifikimin e arsyeve të vonesave dhe sugjerimin e masave korrigjuese. Afati i përfundimit – viti 2025.

-Strategjinë Ndërsërktoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2026.

Aktiviteti 2.2.1: Vlerësimi dhe përditësimi i programeve të formimit fillestar dhe formimit



vazhdues nga secili institucion që punon me ose për fëmijët duke specifikuar trajnimet sipas fushave të përcaktuara në KDPM (neni 26 KDPM) dhe bërja transparente e tyre në faqen zyrtare të institucionit. Institucion kontribues – OSHC, partner vendas.

Aktiviteti 2.2.10.1: Vlerësimi periodik i nevojave për trainim vazhdues.

Aktiviteti 2.2.10.2: Trajnimi vazhdues i punonjësve të shërbimit përmbartimor gjyqësor për të drejtat e fëmijëve.

Aktiviteti 3.2.5: Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët të ofruara në mjedise miqësore në zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor. Institucion kontribues – MD, partner vendas/ndërkombëtarë.

Aktiviteti 3.2.5.1: Përcaktimi i standardeve të mjediseve miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët në zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor, përfshirë personat me aftësi të kufizuar. Afati i mbarimit – viti 2024. Institucion përgjegjës DPP; Institucion kontribues – MD, partner vendas/ndërkombëtarë.

Aktiviteti 3.2.5.2: Krijimi i mjediseve miqësore për fëmijën në zyrën e përmbartimit



gjyqësor Tiranë.

Aktiviteti 3.3.1.1 : Vlerësimi i nevojave për burimet njerëzore të nevojshme dhe rishikimi i organigramës së çdo institucioni që punon me dhe për fëmijët. Institucion kontribues – MD, MFE.

Aktiviteti 3.3.1.2 : Rishikimi i buxhetit të çdo institucioni në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve mbështetëse miqësore për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin.

-Strategjinë Ndërsektorale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit 2024-2030.

Aktiviteti 2.4.1.1: Evidentimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues që adresojnë çështjet e viktimave të krimit. Institucionet partnere – partner vendas dhe ndërkombëtarë.

Aktiviteti 2.4.1.2: Rishikimi i programit fillestar dhe vazhdues nga çdo institucion që punon me/për viktimat e krimit me qëllim përditësimin e programeve sipas problemeve të evidentuara. Institucionet partnere – partner vendas dhe ndërkombëtarë.



		<u>Aktiviteti 2.4.1.4:</u> Hartimi i një formati të unifikuar të të dhënave (“kush bën çfarë”) për programet e trajnimeve të planifikuara dhe/ose të zhvilluara nga të gjitha institucionet trajnuese. Institucionet partnere – partner vendas dhe ndërkombëtarë. <u>Aktiviteti 2.4.1.5:</u> Publikimi i programeve trajnuese të përditësuara në faqet zyrtare të institucioneve që punojnë me viktimat e krimit. Institucion partnere – partner vendas dhe ndërkombëtarë.			
10	Përcjellja e propozimeve për ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, lidhur me dispozitat mbi ekzekutimin e detyrueshëm	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka përcjellë pranë MD, “ Udhërrëfyesi Shteti i së Drejtës” se nenet që kanë nevojë për shtesa dhe ndryshime në Kodin e Prcedurës Civile janë nenet: nent 615/b; neni 518; neni 534; neni 144/a, neni 212 dhe shtese te neni 616 sa i përket pushimit të ekzekutimit për shkak të amnistisë, me qëllim rritjen e numrit të dosjeve të ekzelutuara, përsheptimin e procedurave përmbarimore, në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II-të, , 3 mujori i III-të, 3 mujori i IV-të, 2025/ sipas afateve të përcaktuara në Strategjinë e Drejtësisë 2024-2030.	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit përmbarimor gjyqësor



11	Ndjekja me dinamikë e treguesve statistikore.	Mbledhja e të dhënave statistikore për çdo zyrë përmbarimore, sipas tabelës statistikore të miratuar.	Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Ligjore Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sherbimeve Mbeshtetese dhe Çështjeve Ligjore	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II – të, 3 - mujori i III-të dhe 3 - mujori i IV - të 2025.	Mbledhja e të dhënave statistikore për shërbimin përmbarimor.
12	Ndjekja e proceseve gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.	Ndjekja e çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqimit, me palë Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit sipas autorizimeve përkatëse.	Drejtoria e Përgjithshme të Përmbarimit Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Ligjore Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sherbimeve Mbeshtetese dhe Çështjeve Ligjore	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II – të, 3 - mujori i III-të dhe 3 - mujori i IV - të 2025.	Ndjekja me përgjegjësi e proceseve gjyqësore.
13	Ndjekja e procedurave nga autoriteti përgjegjës i ngritur në zbatim të ligjit për ILDKPKI.	Njoftimi i subjekteve që mbartin detyrim për deklaram dhe plotësim të deklaratës para fillimit të detyrës, të deklaratës periodike vjetore, si dhe të deklaratës pas largimit nga detyra. Pregaditja e raportit vjetor. Ndjekja dhe evidentimi i rasteve të konfliktit të interesave.	Drejtoria e Përgjithshme të Përmbarimit Struktura Përgjegjëse e caktuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm	3- mujori i I-rë, 3-mujori i II – të, 3 - mujori i III-të dhe 3 - mujori i IV - të 2025.	Ndjekja me përgjegjësi e procedurave përkatëse



14	Ndjekja e procedurave ndaj subjekteve që mbartin detyrim ligjor për plotësim dhe dorëzim të formularit të vetdeklarimit.	Njoftimi i subjekteve që mbartin detyrim ligjor për plotësim dhe dorëzim të formularit të vetdeklarimit. Dërgimi i formularëve të plotësuar dhe dorëzuar pranë strukturës së burimeve njerëzore në adresë të Departamentit të administratës Publike.	Drejtoria e Përgjithshme Përmbartimit Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Ligjore Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sherbimeve Mbeshtetese dhe Çështjeve Ligjore	3 - mujori i I-rë, 3-mujori i II-te, 3-mujori i – III – të dhe 3-mujori i - IV, 2025.	Ndjekja procedurave përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore.
15	Përkujdesje në vazhdimësi për mirëmbajtjen dhe rinovimin e faqes zyrtare të Drejtorisë. Pasqyrimi i aktiviteteve të fundit të shërbimit	Evidentim, planifikim dhe realizim në vazhdimësi për mirëmbajtjen dhe përditësimin e faqes zyrtare të Drejtorisë së përgjithshme me aktivitetet e fundit të shërbimit.	DPP/Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Ligjore. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sherbimeve Mbeshtetese dhe Çështjeve Ligjore	3 - mujori i I-rë, 3-mujori i II-te, 3-mujori i – III – të dhe 3-mujori i - IV 2025.	Faqe zyrtare e përditësuar me informacionet e shërbimit.
16	Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të personave fizikë dhe juridikë.	Ushttrim kontrolli me bazë ankesë për ekzekutimin e titujve ekzekutivë në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror. Përgaditja në kohë e kthim përgjigjeve përkatëse pas verifikimit të pretendimeve.	Drejtoria e Përgjithshme Përmbartimit Drejtoria e Inspektimit dhe e Shqyrtimit të Ankesave.	3 - mujori i I-rë, 3-mujori i II-të, 3-mujori i III - të dhe 3 - mujori i - IV – të 2025	Trajtim i plotë dhe korrekt i kërkesave dhe ankesave përkatëse.



17	Përmirësimi i infrastrukturës së ambjenteve të zyrave vendore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.	Evindetimi i nevojës për përmirësimin e infrastrukturës së zyrave vendore. Përgaditja e kërkesës dhe dërgimi në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave për planifikimin dhe realizimin e ambjenteve të zyrave përmbartimore. Identifikimi dhe planifikimi i nevojave për mallra, shërbime dhe furnizime për shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror.	Drejtoria e Përgjithshme të Përmbartimit Sektori i Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria e Burimeve Njerezore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Çështjeve Ligjore Zyrat Vendore të Përmbartimit	3 - muhori i I-rë, 3-muhori i II-te, 3-muhori i - III -të dhe 3-muhori i - IV, 2025.	Zyra Vendore të Përmbartimit me infrastrukturë të përmirësuar për ushtrim aktiviteti.
18	Zbatimi i planit të kontrollit mbi procedurat dhe zbatimin e afateve procedurale të praktikave përmbartimore ne shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror.	Planifikimi dhe miratimi i planit të kontrollit mbi veprimtarinë procedurale, administrative të zyrave vendore.	Drejtoria e Përgjithshme të Përmbartimit Drejtoria e Inspektimit dhe e Shqyrtimit të Ankesave	3 - muhori i I-rë, 3 - muhori i II-të 3 - muhori i III-të 3-muhori i IV -të Viti 2025	Plotësim i objektivave të vendosura për ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga shërbimi përmbartimor gjyqësor shtetëror.
19	Planifikimi, ndjekja dhe zbatimi Buxheiti	-Përgatitja në kohë e situacioneve buxhetore dhe paraqitja e tyre ne Ministrinë e Drejtësisë. - Përllogaritja e fondeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative për shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror. - Hedhja dhe paraqitja e treguesve monitorues. Hartimi i PBA-së për shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror.	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit/Sektori i Financës dhe Buxhetit Zyrat Vendore të Përmbartimit	3 - muhori i I - rë, 3-muhori i II-te, 3-muhori i III - të dhe 3 - muhori i IV - të, 2025	Ndjekja e realizmit të buxhetit

REPUBLICA E SHQIPËRI
DREKTORIA E PËRGJITHSHMË

20	Hartimi i llogarisë vjetore për vitin 2024 për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror.	Plotësimi i tabelave të bilancit dhe mbyllja e llogarive vjetore	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit/Spektori i Financës dhe Buxhetit	3- majori i I –rë 2025	Pasqyrimi me saktësi i llogarisë vjetore për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror.
21	Pregatitja e regjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve për shërbimin.	Pregatitja e regjistrit të parashikimeve për prokurimet për shërbimin. Hedhja e të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve në sistemin e prokurimit publik. Dërgimi i regjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve në Ministrinë e Drejtësisë.	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit/Spektori i Financës dhe Buxhetit	3 - majori i I-rë, 3 - majori i II-të, 3-majori i III - të dhe 3-majori i - IV- të 2025	Ndjekja e realizimit të prokurimeve publike sipas limiteve të përcaktuara.
22	Ndjekja e-detyrave të tjera të cilat dalin gjatë proceseve të punës.	Përcjellja e Shqetësimit të Zyrave Përmbarimore Vendore pranë Ministrisë së Drejtësisë me qëllim zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutiv në lidhje me: Moszbatimin e urdhërave të Sekuestros nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor. Mungesa e mbështetjes nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Territorit dhe Inspektoriateve të Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkive përkatëse.	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Drejtoria e Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave	3 - majori i I-rë, 3-majori i II-të, 3-majori i III - të dhe 3-majori i IV- të, 2025.	Ndjekja dhe përfundimi në kohë i detyrave përkatëse.